

## MENDIM PARALEL

Unë, komisionere Xhensila Pine, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues të subjektit Afrim Shehu, dakordësohem me vendimin e konfirmimit në detyrë të tij, duke parashtruar një arsyetim paralel të ndryshëm, sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë, si më poshtë vijon:

1. Argumentimi i fragmentuar i analizës financiare lidhur me pasuritë e analizuara, në ato të krijuara para vitit 2009, dhe pas këtij viti, si kohë e marrjes së detyrës së prokurorit nga subjekti i rivlerësimit, nuk vjen në harmoni me qëndrimet e mbajtura prej Kolegjit në rastet të tjera të ngjashme, për sa subjekti i rivlerësimit nga viti 2004 ka qenë pjesë aktive e strukturës së prokurorisë, duke qenë se ka ushtruar atributet e oficerit të policisë gjyqësore në seksionet e prokurorisë, duke përfaqësuar një subjekt procedural të rëndësishëm të procedimit penal, për pasojë të dhënies së drejtësisë penale.

2. Për sa më sipër, kam vlerësuar se duhet të analizohet dhe vlerësohet e gjithë analiza financiare e subjektit të rivlerësimit, duke filluar nga viti i parë i deklarimit, viti 2004, deri në vitin 2016.

3. Nga analiza financiare e kryer pas kalimit të rezultateve të hetimit dhe pas analizimit të provave e shpjegimeve të përcjella me prapësimet e subjektot dhe në seancë dëgjimore, kam vlerësuar se:

4. Analiza financiare e vitit 2005 nuk duhet të marrë në konsideratë gjendje *cash* apo mundësi financiare të subjektit për të krijuar gjendje *cash*, pavarësisht gjendjes pozitive financiare të subjektit në vitin e parë të deklarimit, DPV- 2004, për sa referuar hetimit ka rezultuar se në deklaratën e vitit 2004 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash*, dhe në referim edhe të jurisprudencës se Kolegjit lidhur me mungesën e deklarimit të gjendjeve *cash* në deklaratat periodike.

5. Për sa nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë me burime të ligjshme likuiditetet e depozituara në bankë gjatë vitit 2003 për vlerën 1,715,495 lekë, për të cilat subjekti paraqiti prova e shpjegime, se pas tërheqjes nga llogaria bankare ishin përdorur nga familjaret e tij për t'ju rikthyer në vitin 2005, kam vlerësuar se vetëm kjo vlerë duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit nga viti 2005 e në vijim.

6. Analiza financiare gjithashtu duhet të përfshijë të ardhurat nga avokatia në vitet 2002 – 2003 dhe nga shpërblimet sipas parashikimeve në kontratën e punës, për sa subjekti ka arritur të paraqesë prova që provojnë marrëdhënien e punësimit, si dhe përfitimin e tyre, dhe pagimin e detyrimeve tatimore si një kriter kualifikues për standardin e të ardhurës së ligjshme, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore.

7. Analiza financiare nuk duhet të përfshijë vlerën 4,000 USD pretenduar të marrë në muajin gusht të vitit 2003 me vlerë 4,000 USD, e marrë nga shtetasi G.ZH, për sa deklarohet vetëm gjatë procesit e nuk provohet me deklaratimet periodike, por vetëm vlerën 15,296.4 euro, e cila rezultoi e deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rezultoni e provuar se është transferuar me bankë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në vitin 2005, kur dhe u tërhoq nga subjekti dhe për të cilën provohet ligjshmëria e shumës së transferuar.

7.1 Sa më sipër, në analizën financiare duhet rillogaritur edhe kthimi i huas (2007 – 2010) vetëm për vlerën 15,296.4 euro, duke qenë se nuk duhet përfshirë vlera 4,000 USD në vitin 2003.

**8.** Analiza financiare duhet të përfshijë huan nga shtetasi A.SH në vitin 2005, e cila rezulton e deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rezulton e provuar se është transferuar me bankë në llogarinë e subjektit në vitin 2005 kur dhe u tërhoq nga subjekti dhe për të cilën provohet ligjshmëria e shumës së transferuar.

**9.** Analiza financiare duhet të përfshijë vlerën 40,000 euro si dhurim i vjehrrit të subjektit, duke qenë se rezulton e deklaruar në deklaratën para marrjes së detyrës si prokuror DPV e vitit 2009, si dhe për sa u provua mundësia financiare e babait të bashkëshortes për ta krijuar me burime të ligjshme këtë shumë.

**10.** Në analizën financiare, duke qenë se gjendja *cash* e kursimeve prej 15,000 euro, e deklaruar në deklaratën para marrjes së detyrës si prokuror DPV e vitit 2009, nga bashkëshortja e subjektit, nuk provohet për sa i përket ligjshmërisë së burimit, atëherë në vitet në vijim ajo nuk duhet të merret në konsideratë.

**11.** Analiza financiare duhet të llogarisë uljen e shpenzimeve TIMS në vitin 2009 pas përcjelljes së shpjegimeve me prapësime nga ana e subjektit të rivlerësimit, për sa u provua se udhëtimet e kryera janë rimbursuar, pasi kanë qenë trajnime nga OPDAT.

**12.** Analiza financiare duhet të llogarisë uljen e shpenzimeve të kartës së kreditit në vitet 2014 – 2016, për sa u provua nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve se ato ishin paguar për persona të tretë.

**13.** Analiza financiare duhet të konsiderojë vlerë totale të apartamentit në rrugën “\*\*\*\*” çmimin 61,800 euro, e provuar nga mandatet dhe provat e prapësimit nga subjekti i rivlerësimit.

**14.** Vlera e analizës financiare me këto ndryshime rezulton në total për vitet 2005 – 2016 në vlerën negative prej -2,818,068 lekësh, sipas tabelës bashkëlidhur këtij mendimi paralel.

**15.** Duke mbajtur në konsideratë në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën disa rrethana, si: a) Shuma e konstatuar si mungesë burimesh financiare për periudhën 2005 – 2016, e cila vjen edhe për shkak të një analize financiare mbi të dhëna të pranuar, por jo të dokumentuara në drejtim të provueshmërisë lidhur me vitet 2005 – 2009; pasi në këto vite subjekti nuk ka pasur deklarime periodike, b) raportin në të cilin qëndron kjo shumë krahasuar me të ardhurat e pretenduara; c) faktin që në përcaktimin e kësaj balance negative janë konsideruar vetëm të ardhurat e deklaruar e të provuara lidhur me ligjshmërinë dhe me transaksione bankare, kam vlerësuar se mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për vitet 2005 – 2016 në vlerën negative prej -2,818,068 lekësh, është e pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe se në rastin konkret duhet të gjejë vend zbatimi i parimit të proporcionalitetit, për sa balanca negative nuk çënon standardin kushtetues të provimit të bindshëm të ligjshmërisë së pasurisë, duke arritur në konkluzionin se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas arsyetimit të mësipërm.

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

## Tabela financiare për vitet 2005 – 2016 referuar mendimit paralel lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

Përshkrimi	Analiza financiare 2005-01.09.12.2009	dhjetor 2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>13,336,135</b>	<b>-51,840</b>	<b>-501,206</b>	<b>1,315,864</b>	<b>1,072,558</b>	<b>643,152</b>	<b>1,356,138</b>	<b>2,435,485</b>	<b>11,378,991</b>
Apartament me sipërfaqe 72.20 m <sup>2</sup> në Rrugën "D" B*", kontratë sipërmarje datë 30.5.2003, kontratë shitje datë 1.7.2010. Burimi: të ardhurat nga paga si OPGJ ndër vite dhe si avokat 10.4.2002 - 31.12.2003 dhe një vlerë 10.041 euro dhuratë nga A* Sh* (vëllai), me banim në L*, të depozituara në llogarinë e subjektit pranë P* Bank në datë 2.7.2003, T*.	2,902,502								
Garazh, në Rrugën "Q" S**", me sipërfaqe 35m <sup>2</sup> . Kontratë sipërmarje datë 13.11.2009. Vlera 14.000 euro. Burimi: të ardhura nga puna ndër vite së bashku me bashkëshortin.	1,724,555								
Apartament banimi me sip. 103 m <sup>2</sup> , në rrugën "Q" S**". Kontrata e sipërmarjes dt. 04.06.2008. Vlera 61,800 euro. Burimi i krijimit: 1- Dhuratë nga babai 40,000 euro. Deklaratë noteriale nr. ***, rep/kol dt. 27.10.2009. 2- Hua sipas kontratës dt.12.09.2005, vlera 23,000 USD marrë nga N* Q*/G* Zh*.	7,612,679								
Apartament me sipërfaqe 96.5 m <sup>2</sup> në Rrugën "T" D**". Kontratë porosje datë 8.9.2015, kontratë shitje datë 20.10.2016; paguar me kështë datë 8.9.2015 shuma 40.000 euro; datë 8.3.2016 shuma 39.952 euro dhe 18.10.2016 shuma 22.840 euro. Vlera 12.720.000 lekë. Burimi; allogjari kursimi në emër të D* Sh* në U* Bank krijuar me të ardhurat ndër vite; b)- hua nga E* Q* me aktin notarial datë 27.9.2016, (shlyer totalisht me të ardhurat nga shitja e shtëpisë); c)- kursime ndër vite të deklaruara para datës 31.12.2014; d)-shitja e apartamentit me sip. 89.95m <sup>2</sup> me adresë Rruga "Q" S**", T*, sipas kontratës datë 20.10.2016 në vlerën 85.000 euro.								5,506,000	7,147,667
Autoveturë, markë Volkswagen, kontratë shitje datë 12.5.2016. Vlera 8.000 euro. Burimi; shitja e autoveturës e markës Volkswagen GolfPlus me targa * si dhe kursime nga paga.									1,082,160
Autoveturë e markës Volkswagen GolfPlus me targa * blerë në dt. 25.10.2012.					859,910				
Automjeti i markës Volkswagen Golf, me targë *.									
Automjeti i markës Volkswagen Golf, me targë *, blerë në datë 20.03.2007	250,000								
Automjet Opel Corsa, me targë *, datë 6.6.2013. Vlera 900 euro dhe 29.600 lekë detyrim doganor. Burimi; të ardhura të kursyera nga paga.						155,789			
Aksione në vlerën 0.0001% pranë Kompanisë "P*" sha si punonjës e kësaj kompanie të bashkëshortes, blerë në Shkurt 2016 (investuar si vlerë nga paga). Burimi; nga pagat.									
Shitesa/pakës me likuiditete në bankë dhe CASH	846,400	-51,840	-501,206	1,315,864	212,648	487,363	1,356,138	-3,070,515	3,149,165
Total likuiditete	1,201,369	1,149,529	648,323	1,964,187	2,176,835	2,664,198	4,020,336	949,821	4,098,986
<b>DETYRIME</b>	<b>825,782</b>	<b>0</b>	<b>-825,782</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>633,200</b>	<b>-641,450</b>
Hua marrë nga shtetasi N* Q*/G* Zh* me kontratë datë 12.09.2005 në vlerën 23,000\$	825,782		(825,782)						
Hua marrë nga shtetasi E* Q* me akt noterial dt. datë 27.9.2016; në vlerën 40,000 euro dhe 5,000 USD në dt. 08.09.2015.								633,200	-641,450
<b>PASURINETO</b>	<b>12,510,354</b>	<b>-51,840</b>	<b>324,576</b>	<b>1,315,864</b>	<b>1,072,558</b>	<b>643,152</b>	<b>1,356,138</b>	<b>1,802,285</b>	<b>12,020,441</b>
<b>TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA</b>	<b>13,134,164</b>	<b>142,103</b>	<b>2,389,116</b>	<b>3,127,317</b>	<b>2,519,588</b>	<b>2,417,053</b>	<b>2,384,408</b>	<b>2,480,668</b>	<b>15,013,853</b>
Të ardhura nga emigronimi, nga 20.05.1992-01.09.1995. Vlera 2,000,000 lekë.									
Të ardhura nga kompanitë rentiere (V* shpk)									
Të ardhura nga paga si OPGJ, për periudhën 16.10.1999-10.04.2002 dhe vlera e ekzekutimit të vendimit të civkates.	3,510,814	72,731							
Të ardhura nga puna si avokat datë 10.4.2002 - 31.12.2003, në Studion Ligjore me NIPT *. Shuma 2,518,333 lekë.									
Të ardhura nga detyra si Oficer i Policisë Qytësore 2004-10.12.2009 si dhe Prokuror datë 10.12.2009 - 31.12.2016. Shuma 13,972,719 lekë.		14,937	1,162,385	1,291,633	1,140,852	1,142,145	1,317,145	1,267,398	1,293,551
Të ardhura nga paga e bashkëshortes, si specialiste pranë M* & D* (tetor 2005-shkurt 2008), pranë P* A** sha dhe P* G** sha. Shuma 11,075,784 lekë.	2,427,129	54,435	1,226,653	1,384,250	1,344,976	1,229,233	1,032,358	1,194,100	1,396,442
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës Volkswagen Golf, me targë * (kontratë shitje datë 27.1.2007, blerë me të ardhurat nga pagat). Shuma 200,000 lekë.	200,000								
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës Volkswagen Golf, me targë * (kontratë shitje datë 6.9.2011, blerë me të ardhurat nga pagat). Shuma 450,000 lekë.				450,000					
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës Volkswagen GolfPlus me targë * (kontratë shitje datë 11.5.2016, blerë me të ardhurat nga shitja e automjetit të mësipërm). Shuma 6,100 euro.									825,147
Dhuratë nga vëllai në A*, (A* Sh*) në vitin 2004 në shumën 12,760 euro kaluar në llogarinë nr. * në P* B* dhe në datë 28.5.2008 kaluar në llogarinë * në GBP, RFB.	319,150								
Të ardhura nga trajnim (kaluar në llogarinë * në USD - RFB), si trajnues i trajnuesve pranë Shkolles së M*, organizuar nga O*, kaluar nënshkrimet bankë në datë 13.5.2013. Shuma 994 USD.									
Të ardhura nga trajnim i organizuar nga O*, në K*, në datat 26.9.2016-30.9.2016. Shuma 556 USD.									
Të ardhura nga trajnim i organizuar nga O*, në K*, në datat 29.3.2015, 5.6.2015, 6.11.2015 dhe 11.12.2015. Shuma 1,690 USD.									
Të ardhura nga shitja e e apartamentit me sipërfaqe 89.95 m <sup>2</sup> , në Rrugën "Q" S**", T* sipas kontratës datë 20.10.2016. Shuma 85,000 euro.									11,497,950
Dhuratë në vlerën 40,000 euro nga shtetasi P* G*, (babai i bashkëshortes), dhuratë për D* Sh* (bashkëshortja) sipas aktit notarial datë 27.10.2009. Burimi i shumës së dhuruar është nga puna e tij në Q* që në vitin 1999, vërtetuar kjo me vitin ndër vite, kjo punë me nr.* datë 1.8.2003 si dhe dokumentat e dorëzuara në organet tatimore në Q* që provojnë të ardhurat maioe.	4,927,300								
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë U* bank				1,386	33,711	45,612	34,862	19,161	754
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë R* bank	32,762								
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë P* bank	1,514		78	48	49	63	43	8	9
	1,715,495								
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,146,191</b>	<b>45,540</b>	<b>1,464,771</b>	<b>1,223,123</b>	<b>755,104</b>	<b>825,511</b>	<b>1,454,960</b>	<b>1,547,378</b>	<b>2,885,224</b>
Shpenzime shkollimi për fëmijët, në shkollën "V* e D*" T* për vitin akademik 2016-2017. Vlera 2,550 euro paguar në shtator 2016, 550 euro dhe në janar 2017, vlera 2,000 euro.								240,888	74,399
Shpenzime për mobilim e apartamentit të ndodhur në rr. Q* S* sipas pyetësor standart			832,860	553,200					
Shpenzime mirëmbajtje të automjetit me targa * sipas shpjegimeve në pyetësor nr. 2	398,950								
Shpenzime për mobilimin e apartamentit në Rrugën "T" D**", Vlera 11,000 euro.									1,487,970
Shpenzime siguracioni për automjetin rezultuar nga A*							30,950	15,360	14,760
Shpenzime pagesë për kartën e kreditit të bashkëshortes pranë U* Bank									
Shpenzime udhëtimi sipas funksionit			77,000	77,000	77,000	77,000	77,000	77,000	77,000
Shpenzime udhëtimi	86,308	-	8,431	46,443	119,912	184,415	467,018	317,027	290,727
Shpenzime jetike	1,660,934	45,540	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>-1,522,381</b>	<b>148,403</b>	<b>599,769</b>	<b>588,331</b>	<b>691,926</b>	<b>948,391</b>	<b>-426,691</b>	<b>-868,996</b>	<b>108,187</b>